



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 5.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR
BASHKËPUNIM FINANCIAR 2017, PËR PROJEKTIN “PROMOVIMI I
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME PËRMES FONDIT TË
GARANCISË SË KREDIVE RURALE””**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 5 nëntor, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale””, propozuar nga Këshilli i Ministrave në përputhje me nenet 81, pika 1, 100 dhe 121, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Marrëveshja e miratuar në parim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.487, datë 31.7.2018, konsiston në dhënien e shumës së financimit me vlerë prej 5 000 000 euro për përmbushjen e objektivit të inkurajimit të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mbi një bazë të qëndrueshme, duke garantuar kreditë tregtare të institucioneve mikrofinanciare, të cilat do t’u ofrojnë kredi kredimarrësve në segmentin bujqësor e rural të ekonomisë që ndikojnë drejtëpërsëdrejti në rritjen e konkurrueshmërisë së tyre dhe krijimin e vendeve të reja të punës në bujqësi.

Marrëveshjeja ka interes si në aspektin ekonomik dhe në atë social, duke marrë në konsideratë nevojën për mbështetje financiare dhe shtysa të mëtejshme në fushën e promovimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.

Kushtet me të cilat vihet në dispozicion marrëveshja, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen ndërmjet KfW-së dhe të marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

Në nenin 3, të marrëveshjes është përcaktuar përjashtimi i KfW-së nga të gjitha tatimet dhe taksat direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë, në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të këtij projekti.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Fondi Rural i Garancisë së Kredive

Gjatë shqyrtimit u vlerësua fakti se zbatimi i marrëveshjes ndërvaret nga përmbushja e kushteve dhe procedurave të brendshme që kërkojnë hyrjen në fuqi menjëherë të projektligjit, prandaj Komisioni miratoi ndryshimin e nenit 2, si më poshtë:

“Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare’.”

Në përfundim të diskutimeve, duke pasur parasysh se marrëveshja është në përputhje me programin e qeverisë për zhvillimin ekonomik të sektorit të bujqësisë, Komisioni e miratoi projektligjin me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

RELATOR

KRYETAR

Ervin BUSHATI

Erjon BRAÇE